

VENDIM
Nr. 586, datë 25.9.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT (REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE VORË–HANI I HOTIT), NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE HEKURUDHËS SHQIPTARE SHA, DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË LIDHJE ME NJË GRANT INVESTIMI NGA
FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit (rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë–Hani i Hotit), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hekurudhës Shqiptare sh.a., dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PËR PËRDORIM ZYRTAR

VERSION EKZEKUTIMI
(Numri i veprimit 53468)

MARRËVESHJE GRANTI
(REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE VORË–HANI I HOTIT)
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE HEKURUDHA SHQIPTARE SHA
DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
NË LIDHJE ME NJË GRANT INVESTIMI NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN
PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Datë 26 korrik 2024

Tabela e lëndës

NENI I. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

Seksioni 1.01 Përkufizimet

Seksioni 1.02 Interpretimi

NENI II. FINANCIMI I GRANTIT

Seksioni 2.01 Shuma, valuta dhe qëllimi

Seksioni 2.02 Disbursimet

Seksioni 2.03 Angazhimet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara të rimbursimit

Seksioni 2.04 Rishpërndarja

Seksioni 2.05 Anulimi nga Sovrani

Seksioni 2.06 Pagesat

NENI III. EKZEKUTIMI I PJESËS 1 TË PROJEKTTIT

Seksioni 3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

Seksioni 3.02 Përgjegjësitë që lidhen me ekzekutimin e pjesës 1 të Projektit

Seksioni 3.03 Pajtueshmëria mjedisore dhe sociale

Seksioni 3.04 Detyrimet për mbështetje të sovranit

Seksioni 3.05 Njësia e Zbatimit të Projektit

Seksioni 3.06 Prokurimet

Seksioni 3.07 Dokumentet dhe raportet e Projektit, kontrollet

Seksioni 3.08 Dhënia e Grantit

NENI IV. ANGAZHIMET FINANCIARE DHE OPERATIVE

Seksioni 4.01 Dokumentet dhe raportet financiare

Seksioni 4.02 Kryerja e biznesit dhe veprimeve

Seksioni 4.03 Taksat

Seksioni 4.04 Vizibiliteti

Seksioni 4.05 Mashtrimi dhe korrupsioni

Seksioni 4.06 Puna e fëmijëve

NENI V. PEZULLIMI DHE ANULIMI; RIMBURSIMI

Seksioni 5.01 Pezullimi

Seksioni 5.02 Anulimi nga Banka

Seksioni 5.03 Angazhimet e rimbursimit të pakushtëzuara të paprekura nga pezullimi ose anulimi

Seksioni 5.04 Detyrimet e Sovranit dhe Subjektit të Projektit

Seksioni 5.05 Rastet e kompensimit

Seksioni 5.06 Rikuperimi

NENI VI. ZBATUESHMËRIA, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Seksioni 6.01 Zbatueshmëria

Seksioni 6.02 Mosushtrimi i të drejtave

Seksioni 6.03 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

NENI VII. HYRJA NË FUQI, PËRFUNDIMI

Seksioni 7.01 Data e hyrjes në fuqi

Seksioni 7.02 Kushtet para hyrjes në fuqi

Seksioni 7.03 Opinioni ligjor

Seksioni 7.04 Kushtet shitesë para disbursimit

Seksioni 7.05 Përfundimi për moshyrjen në fuqi

Seksioni 7.06 Përfundimi me realizimin e përmbushjes

NENI VIII. TË NDRYSHME

Seksioni 8.01 Njoftimet

Seksioni 8.02 Autoriteti për të vepruar

Seksioni 8.03 Ndryshimet

Seksioni 8.04 Gjuha angleze

Seksioni 8.05 Zhdëmtimi

Seksioni 8.06 Delegimet

Seksioni 8.07 Të drejtat, mjetet juridike dhe heqjet dorë

Seksioni 8.08 Përfaqësimet – Praktikë e ndaluara dhe Subjekti i Përrjashtuar

Seksioni 8.09 Zbulimi i informacionit

Seksioni 8.10 Përgjegjësia e kontribuuesve të Fondit

Seksioni 8.11 Kopjet

SKEDULI 1. ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI
SHTOJCA 1. FORMA E KËRKESËS PËR DISBURSIM
SHTOJCA 2. FORMA E LETRËS ME ANË TË SË CILËS ÇAKTOHEN NËNSHKRUESIT
E AUTORIZUAR

MARRËVESHJE GRANTI

Marrëveshje, e datës 26 korrik 2024, ndërmjet **Republikës së Shqipërisë** (“Sovrani”), **Hekurudha Shqiptare sh.a.** (“Subjekti i Projektit”) dhe **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim** (“Banka” ose “BERZH”).

Preambulë

Duke pasur parasysh se:

A. BERZH-i është një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar në bazë të së drejtës ndërkombëtare në përputhje me Marrëveshjen për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja për Themelimin e Bankës”), të datës 29 maj 1990.

B. Sovrani ka kërkuar ndihmë për financimin e një pjese të Projektit (siç përcaktohet më poshtë), i cili është projektuar për të ndihmuar në rehabilitimin dhe elektrifikimin e linjës hekurudhore prej rreth 120 km ndërmjet Vorës dhe Hanit të Hotit.

C. Banka ka lidhur një marrëveshje huaje, të datës 26 shkurt 2024, me Sovranin në cilësinë e tij si Huamarrës, në bazë të së cilës Banka si huadhënës do të japë një hua deri në shumën 98,750,000 EURO (nëntëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro) për financimin e një pjese të Projektit, siç përshkruhet në skedulin 1 të tij (“Projekti”), sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e huas siç mund të ndryshohet herë pas here (“Marrëveshja e Huas”).

D. Banka gjithashtu ka lidhur një marrëveshje projekti, të datës 4 mars 2024, me Subjektin e Projektit siç mund të ndryshohet herë pas here (“Marrëveshja e Projektit”), në bazë të së cilës, duke marrë parasysh hyrjen e Bankës në Marrëveshjen e Huas dhe në këtë Marrëveshje, Subjekti i Projektit do të pranojë të kryejë projektin në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Projektit.

E. Në bazë të nenit 20 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës, Banka ka krijuar Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“Fondit”) të cilin BERZH-i e menaxhon dhe administron në përputhje me kushtet e përgjithshme, të datës 7 nëntor 2006, siç mund të ndryshohet herë pas here (“Kushtet e përgjithshme të Fondit”).

F. Më 1 prill 2022, Asambleja e Kontribuuesve të Fondit, ra dakord, sipas termave dhe kushteve të kushteve të përgjithshme të Fondit, t’i japë Sovranit një grant në një shumë që nuk kalon vlerën 125,813,039 EURO (njëqind e njëzet e pesë milionë e tetëqind e trembëdhjetë mijë e tridhjetë e nëntë Euro) nga burimet e Fondit, bazuar në dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të caktuara në lidhje me pjesën 1 të Projektit.

Tashmë, si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Përkufizimet dhe interpretimi

Seksioni 1.01 Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën, shtojcat dhe skedulet), por që nuk përcaktohen këtu, do të kenë të njëjtin kuptim që u jepet në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Projektit dhe/ose në termat dhe kushtet standarde (duke

përfshirë aty ku termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde janë ndryshuar në Marrëveshjen e Huas) kur përdoren në këtë Marrëveshje.

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë preambulën, shtojcat dhe skedulet), përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Marrëveshje që krijon Bankën” ka kuptimin që jepet në pikën A.

“Kontratat” do të thotë kontratat në funksion ose që do të lidhen ndërmjet Subjektit të Projektit dhe çdo Kontraktori, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të lidhura me pjesën 1 të Projektit, duke përfshirë Zërat e Financuar nga Granti dhe që do të financohen tërësisht ose pjesërisht me financimin e Grantit.

“Kontraktorë” do të thotë kontraktorët me pozitë dhe reputacion që do të angazhohen nga Subjekti i Projektit në lidhje me prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të lidhura me Pjesën 1 të Projektit, duke përfshirë Zërat e Financuar nga Granti, me secilin kontraktor të tillë që do të zgjidhet në përputhje me seksionin [3.06] (Prokurimi).

“Disbursim” do të thotë disbursimi i çdo pjese të financimit të Grantit herë pas here në bazë të seksionit [2.02] (*Disbursimet*) të kësaj Marrëveshjeje.

“Sistemi i zbulimit dhe përjashtimit të hershëm” do të thotë sistemi i krijuar nga rregullorja (BE, Euratom) nr. 2015/1929, të datës 28 tetor 2015, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit (GZ L 286/1, 30.10.2015), i cili përfshin informacion mbi zbulimin e hershëm të rreziqeve që kërcënojnë interesat financiare të BE-së, për rastet e përjashtimit nga financimi i BE-së të personave juridikë dhe fizikë dhe për rastet e vendosjes së penalteteve financiare.

“Datë e hyrjes në fuqi” do të thotë data kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi në përputhje me seksionin [7.01] (*data e hyrjes në fuqi*) të kësaj Marrëveshjeje.

“Masa kufizuese të BE-së” do të thotë masat kufizuese të miratuara në zbatim të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) ose Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).

“Subjekt i përjashtuar” do të thotë një Subjekt:

a) i cili ka qenë objekt i një vendimi të formës së prerë (vendim që ka fuqinë e *res judicata*) ose të një vendimi administrativ të formës së prerë (vendim i një autoriteti administrativ që ka efekt përfundimtar dhe të detyrueshëm në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm) për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim të parave, vepra të lidhura me terrorizmin, punë të fëmijëve ose trafikim të qenieve njerëzore, shmangie të taksave, mashtrim fiskal dhe evazion fiskal, ose për një parregullsi që cenon interesin financiar të BE-së;

b) që është fajtor për keqinterpretim në dhënien e informacionit që kërkohet si kusht për pjesëmarrje në financimin e Grantit ose nëse nuk mund të japë këtë informacion;

“Fond” ka kuptimin që jepet në pikën [E].

“Kushtet e përgjithshme të Fondit” ka kuptimin që jepet në pikën [E].

“Zërat e Financuar nga Granti” do të thotë mallrat, punët dhe shërbimet përkatëse të nevojshme për pjesën 1 të Projektit dhe që do të financohen nga financimi i Grantit, siç përshkruhet më tej në skedulën 1 (*Zërat e Financuar nga Granti*) të kësaj Marrëveshjeje.

“Financim i Grantit” ka kuptimin që jepet në seksionin [2.01(a)]

(*Shuma, valuta dhe qëllimi*) i kësaj Marrëveshjeje.

“Shuma fillestare e Grantit” ka kuptimin që jepet në seksionin [2.01(a)(1)]

(*Shuma, valuta dhe qëllimi*) i kësaj Marrëveshjeje.

“Datë e fundit e disponueshmërisë së financimit të Grantit” do të thotë data e specifikuar në seksionin [2.02(a)] (*Data e fundit e disponueshmërisë së financimit të Grantit*) të kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshje Huaje” ka kuptimin që jepet në pikën [C].

“Financim i Huas” do të thotë financimi i vendosur ose që do të vihet në dispozicion nga Banka për Sovranin në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas dhe që vihet në dispozicion të ose për interes të Subjektit të Projektit, në përputhje me seksionin 3.01(a) të Marrëveshjes së Huas.

“OLAF” do të thotë Zyra Evropiane kundër Mashtrimit e autorizuar nga Bashkimi Evropian.

“Plan prokurimi” do të thotë plani i prokurimit për Projektin, duke përfshirë Zërat e Financuar nga Granti, të cilët do të jenë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in, ndërsa një plan i tillë ndryshohet herë pas here nga Sovrani, nëpërmjet Subjektit të Projektit, me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës

“Praktikë e ndaluar” ka kuptimin që jepet në politikat dhe procedurat e zbatimit në fuqi që nga data e kësaj Marrëveshjeje.

“Projekt” ka kuptimin që jepet në pikën [C].

“Marrëveshje e Projektit” ka kuptimin që jepet në pikën [D].

“Datë e përfundimit të Projektit” do të thotë data kur kanë ndodhur të gjitha sa vijon:

a) Subjekti i Projektit t'i ketë dorëzuar Bankës dhe inxhinierit të mbikëqyrjes së Projektit një njoftim, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, me anë të së cilit vërtetohet se pjesa 1 e Projektit ka përfunduar.

b) Banka të ketë marrë një certifikatë nga inxhinieri i mbikëqyrjes së Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, me anë të së cilës konfirmohet pa asnjë rezervë materiale se pjesa 1 e Projektit ka përfunduar; dhe

c) Banka t'i ketë dhënë Subjektit të Projektit një njoftim me anë të së cilit konfirmohet se Banka është e bindur që pjesa 1 e Projektit ka përfunduar.

“Përfaqësues i autorizuar i Subjektit të Projektit” do të thotë administratori i Subjektit të Projektit.

“Inxhinier i mbikëqyrjes së Projektit” do të thotë një konsulent i angazhuar ose që janë marrë masat për tu angazhuar nga Subjekti i Projektit, në përputhje me seksionin [2.06(a)] (*Konsulentët*) të Marrëveshjes së Projektit për të asistuar me mbikëqyrjen e pjesës 1 të Projektit.

“Angazhim për rimbursim” do të thotë një angazhim i përmendur në seksionin [2.03]. (*Angazhimet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara të rimbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje, dhe mund të jetë një “Angazhim rimbursimi i kushtëzuar” ose “Angazhim rimbursimi i pakushtëzuar”, siç ata terma përdoren në atë seksion.

“Person i kufizuar” do të thotë çdo subjekt, individ ose grupe individësh të caktuar nga BE-ja në bazë të masave kufizuese të BE-së.

“Përfaqësues i autorizuar i Sovranit” do të thotë ministri i Financave të Sovranit, përveç siç specifikohet në seksionin 2.02 (d).

“Termat dhe kushtet standarde” do të thotë termat dhe kushtet standarde të Bankës të datës 5 nëntor 2021.

“Dokumentet e transaksionit” ka kuptimin që jepet në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

a) fjalët që tregojnë njëjës në përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe;

b) titujt dhe tabela e përmbajtjes janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë dhe referencat për një person përfshijnë pasuesit e tij dhe drejtëmarrësit e lejuar; dhe

d) referenca ndaj një neni, seksioni, skeduli ose shtojce të specifikuar, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni të specifikuar, ose skeduli ose shtojce të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II **Financimi i Grantit**

Seksioni 2.01 Shuma, valuta dhe qëllimi

a) Sipas dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, Banka pranon t'i japë Sovranit, nga Fondi, një grant në shumën deri në vlerën 125,813,039 euro (njëqind e njëzet e pesë milionë e tetëqind e trembëdhjetë mijë e tridhjetë e nëntë euro).

b) Financimi i Grantit që Banka siguron nga Fondi, do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të Zërave të Financuar nga Granti, të cilët do të prokurohen në përputhje me seksionin 3.06 (*Prokurimi*) të kësaj Marrëveshjeje

c) Sipas seksionit [5.05] (*Rastet e rimbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje, financimi i Grantit është pa rimbursim.

d) Pranohet dhe bihet dakord shprehimisht, se: (i) Banka nuk do të ketë detyrimin të kryejë ndonjë disbursim ose pagesë tjetër sipas ose në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përveç në masën që një shumë në lidhje me dhe të barabartë me këtë disbursim ose një pagesë e tillë është e disponueshme në Fond për një qëllim të tillë; dhe (ii) financimi i Grantit mund të reduktohet me anë të interesit negativ të zbatueshëm për llogarinë bankare ku mbahen burimet e Fondit.

e) Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

1. Sipas paragrafit (2) dhe seksionit 2.02 (c) më poshtë, Zërat e Financuar nga Granti do të bashkë-financohen nga financimi i Grantit dhe financimi i Huas në raporte dhe shuma që do të përcaktohen në Planin e Prokurimit; dhe

2. shuma e financimit të Grantit të alokuar për çdo Zë të veçantë të Financuar nga Granti sipas Skedulit 1, nuk do të kalojë në asnjë moment 50 për qind të kostove totale të komponentit të infrastrukturës për pjesën 1 të Projektit (siç përcaktohet në paragrafin 2 (A)(a) e skedulit 1 (*Përshkrimi i Projektit*) të Marrëveshjes së Huas) të ndodhur më pas.

f) Financimi i Grantit nuk do të përdoret për të paguar ndonjë nga kostot e mëposhtme:

1. koston e blerjes së tokës ose ndërtesave;
2. ndonjë detyrim, taksë dhe tarifë, duke përfshirë por pa u kufizuar në tatimin mbi vlerën e shtuar, të cilat janë të rikuperueshme ose të zbritshme;
3. kthimin e kapitalit;
4. borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit;
5. tarifat bankare;
6. kostot e shkaktuara gjatë dhe që lidhen me pezullimin e zbatimit të (në tërësi ose pjesërisht) të pjesës 1 të Projektit;
7. çdo kontribut në natyrë.

Seksioni 2.2 Disbursimet

Sipas seksionit [5.01] (*Pezullimi*), seksionit [5.02] (*Anulimi nga Banka*), seksionit [7.02] (*Kushtet para hyrjes në fuqi*) dhe seksionit [7.04] (*Kushtet shitesë para disbursimit*) dhe seksionit [7.05] (*Kushtet para disponueshmërisë së shumës vijuese të Grantit*) të kësaj Marrëveshjeje, Financimi i Grantit do të disbursohet nga Banka herë pas here, në një ose më shumë disbursime, sipas dispozitave të mëposhtme:

a) Data e fundit e disponueshmërisë së financimit të Grantit

E drejta e Sovranit për të kërkuar një disbursim në përputhje me këtë Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 2030 ("Data e fundit e

disponueshmërisë së financimit të Grantit”), përveç nëse Banka bie dakord për një datë të mëvonshme përfundimi dhe njofton Sovranin për këtë zgjatje afati me shkrim.

b) Shpenzimet e pranueshme

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, disbursimet do të bëhen vetëm për financimin e:

1. shpenzimeve të kryera (ose, nëse Banka bie dakord, të kryhen) në lidhje me kostot e arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti; dhe

2. shpenzimeve të kryera pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

c) Kushtet për disbursim

Pa kufizuar përgjithësinë e këtij seksioni 2.02, çdo disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me një ose më shumë Zëra të Financuar nga Granti, do t’i nënshtrohet përmbushjes, ose sipas gjykimit të vetëm të Bankës, heqjes dorë, tërësisht ose pjesërisht dhe nëse sipas kushteve ose pa kushte të kushtit që në datën e kërkesës së Sovranit për këtë disbursim, shuma e financimit të Huas së tërhequr ose të kërkuar sipas një aplikimi të pranueshëm për tërheqje nga Sovrani në cilësinë e tij si Huamarrës (“Shuma e financimit të Huas) është i tillë që raporti i shumës së financimit të Huas me shumën e financimit të Grantit të disbursuar ose të kërkuar sipas një aplikimi të pranueshëm për “disbursim nga Sovrani, është të paktën 40:60.

d) Kërkesa për disbursim

1. Sovrani mund të kërkojë një disbursim duke i paraqitur Bankës një kërkesë origjinale për këtë disbursim, të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Subjektit të Projektit, ose një person i caktuar nga përfaqësuesi i autorizuar i Subjektit të Projektit, ku secili prej këtyre personave caktohet si përfaqësues i autorizuar i Sovranit për qëllimet e seksionit 2.02 (d). Çdo kërkesë për disbursim do të jetë në formën e shtojcës 1 (*Formulari i kërkesës për disbursim*) dhe do t’i dorëzohet Bankës të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune përpara datës së propozuar të vlerës së këtij disbursimi. Një kërkesë e tillë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, do të jetë e parevokueshme dhe e detyrueshme për Sovranin.

2. Çdo kërkesë për disbursim do të shoqërohet me dokumente të tilla dhe dëshmi të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur Bankën që Sovranit i jepet e drejta për të marrë shumën e disbursimit dhe se shuma e disbursimit do të përdoret ekskluzivisht për Zërat e Financuar nga Granti. Këto dokumente do të përfshijnë, por pa u kufizuar në faturën(at) e Kontraktorit, të vërtetuara (nëse kërkohet nga kontrata përkatëse) nga ose në emër të Sovranit, qoftë në faturën aktuale ose në formën e një certifikate të veçantë, me anë të së cilës tregohet konfirmimi i Sovranit që mallrat, punët ose shërbimet janë dorëzuar ose kryer në mënyrë të pranueshme në përputhje me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe kontratës përkatëse.

e) Valuta e disbursimeve

Disbursimet do të bëhen në EURO në një shumë të barabartë ose ekuivalente me shpenzimet që do të financohen nga të ardhurat e financimit të Grantit. Në rastin e shpenzimeve të kryera në një valutë ose valuta të ndryshme nga EURO, shuma ekuivalente e disbursimit do të përcaktohet si më poshtë:

1. Nëse Sovrani kërkon pagesën në EURO, shuma e disbursimit do të përcaktohet nga Banka në bazë të kostos së këmbimit që do të kishte ndodhur nga Banka nëse do të kishte blerë valutë ose valuta të tilla për të përmbushur kërkesën.

2. Nëse Sovrani kërkon pagesën në valutën ose valutat e shpenzimeve, Banka, me kusht që këto shpenzime të jenë në valuta ose valutë lehtësisht të disponueshme, do të blejë një valutë ose valuta të tilla në një mënyrë që Banka mund ta çmojë të përshtatshme. Shuma ekuivalente e disbursimit do të përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit që kishin ndodhur ose që do të kishin ndodhur nga Banka duke përdorur valutën EURO për të përmbushur kërkesën.

f) Pagesat në valuta të tjera

Në rrethana të jashtëzakonshme, Banka mund të pranojë një kërkesë nga Sovrani që pagesa të bëhet në një valutë ose valuta të ndryshme nga valuta EURO ose valuta e shpenzimeve. Në atë rast, Banka do të blejë valutë ose valuta të tilla në atë mënyrë që Banka mund ta çmojë të përshtatshme. Shuma ekuivalente e disbursimit do të përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit që kishin ndodhur ose që do të kishin ndodhur nga Banka, duke përdorur valutën EURO për të përmbushur kërkesën.

g) *Shuma minimale e disbursimit*

Me përjashtim të disbursimit të fundit ose nëse Banka bie dakord ndryshe, disbursimet do të bëhen në shuma jo më pak se 50,000 EURO (pesëdhjetë mijë euro).

h) *Dispozitat shitesë në lidhje me financimin e granteve*

Para datës 31 dhjetor 2030:

- i. të gjitha kostot që do të financohen nga financimi i Grantit duhet të lëvrohen; dhe
- ii. financimi i Grantit duhet të disbursohet.

i) *Disponueshmëria e fondeve për Bankën*

a) Banka nuk do të ketë detyrimin të kryejë asnjë pagesë të financimit të Grantit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përveç në masën që nga Fondi të jenë vënë në dispozicion për Bankën fonde të mjaftueshme për këtë qëllim.

b) Pa cenuar përgjithësinë e paragrafit “a” më sipër, Sovrani pranon se në datën e kësaj Marrëveshjeje, Fondi ka vënë në dispozicion për Bankën fonde që do të zbatohen për financimin e Grantit në një transh fillestar në shumën 107,000,000 EURO, me transhin vijues që mbulon shumën e mbetur të financimit të Grantit që pritet t’i vendoset në dispozicion Bankës në një datë më të vonshme. Disponueshmëria e shumës së mbetur të financimit të Grantit kushtëzohet me vënien në dispozicion nga Fondi për Bankën të shumës së mbetur të fondeve për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03 Angazhimet e rimbursimit të kushtëzuar dhe të pakushtëzuar

a) Me kërkesën e Sovranit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, Banka mund të lëshojë, në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Manualit të Disbursimit të BERZH-it *mutatis mutandis*, angazhime rimbursimi të pakushtëzuara ose të kushtëzuara për të rimbursuar pagesat e kryera nga bankat sipas letrave të kredisë në lidhje me shpenzimet që do të financohen nga financimi i Grantit. Çdo rimbursim i tillë do të përbëjë një disbursim.

b) Në rastin e një angazhimi rimbursimi të kushtëzuar, detyrimi i Bankës për të paguar do të pezullohet ose ndërpritet menjëherë pas çdo pezullimi ose anulimi të financimit të Grantit nga Banka në përputhje me seksionin [5.01] (*Pezullimi*) ose Seksionin [5.02.] (*Anulimi nga Banka*) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Në rastin e një angazhimi rimbursimi të pakushtëzuar, detyrimi i Bankës për të paguar nuk do të ndikohet nga ndonjë pezullim ose anulim i mëvonshëm i financimit të Grantit.

Seksioni 2.04 Rialokimi

Sovrani mund t’i kërkojë Bankës që të riallokojë shumat e alokuara ndaj secilit zë të Zërave të Financuar nga Granti të renditur në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që një rialokim i tillë të jetë në përputhje me kushtet e përgjithshme të Fondit. Banka mund të japë kërkesën e rialokimit me anë të njoftimit drejtuar Sovranit. Një rialokim i tillë do të hyjë në fuqi kur të jepet njoftimi.

Seksioni 2.05 Anulimi nga Sovrani

Sovrani mund të anulojë në çdo kohë, tërësisht ose pjesërisht, duke i dërguar Bankës njoftim me shkrim jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë pune para, çdo pjesë të padisbursuar të financimit të Grantit. Çdo njoftim i tillë anulimi nga Sovrani do të jetë i parevokueshëm dhe i detyrueshëm për Sovranin.

Seksioni 2.06 Pagesat

a) Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, shumat që do të disbursohen nga Banka sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhen drejtpërdrejt në llogarinë e Kontraktorit përkatës, siç përcakton

Sovrani në kërkesën e tij për disbursim. Banka do të kryejë pagesa vetëm me anë të pagesës elektronike në një llogari bankare të mbajtur në emër të Kontraktorit dhe që ndodhet në vendin e themelimit ose vendbanimit të Kontraktorit, sipas rastit, ose (me pëlqimin paraprak të Bankës) në vendin ku Kontraktori ofron mallrat ose punët, ose ku Kontraktori kryen shërbimet.

b) Nëse data e kërkuar për ndonjë pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje do të binte në një ditë që nuk është ditë pune, atëherë kjo pagesë do të paguhet në ditën tjetër të ditës vijuese të punës.

c) Çdo shumë që mund të bëhet e kërkueshme për Bankën sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet, pa kompensim ose kundërpretendim në EURO, për vlerën në datën e kërkueshme, në një llogari të tillë në Londër, Angli ose një vend tjetër që Banka mund të caktojë herë pas here, duke i dërguar njoftim Sovranit.

Neni III

Ekzekutimi i pjesës 1 të Projektit

Seksioni 3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Dispozitat e seksionit 4.01 (*Bashkëpunimi dhe informacioni*) të termave dhe kushteve standarde do të zbatohen sikur të jenë të përcaktuara këtu plotësisht *mutatis mutandis*, duke përfshirë pa cenuar përgjithësinë e tyre, sikur:

- i. referencat për “Huamarrësin” dhe “Garantin” të lexoheshin si referenca për “Sovranin”;
- ii. referencat për “Huan” të lexoheshin si referenca për “Financimin e granteve”; dhe
- iii. referencat për “Marrëveshjen e Huas” dhe “Marrëveshjen e Projektit” të lexoheshin si referenca për “këtë Marrëveshjeje.

b) Në marrjen e informacionit në përputhje me Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Projektit, Banka mund të përdorë dhe të bazohet në çdo informacion të tillë në cilësinë e saj si ofrues i financimit të Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Përgjegjësitë në lidhje me ekzekutimin e pjesës 1 të Projektit

a. Subjekti i Projektit, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

1. do të realizojë pjesën 1 të Projektit me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me Marrëveshjen e Projektit dhe këtë Marrëveshje;
2. do të realizojë pjesën 1 të Projektit në përputhje me Planin e Prokurimit, sipas ndonjë modifikimi për të cilin Banka mund të shprehet dakord me shkrim;
3. do të realizojë pjesën 1 të Projektit në përputhje me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social dhe kërkesat e përcaktuara të performancës;
4. do të marrë masa që data e përfundimit të Projektit të ndodhë jo më vonë se data [31 dhjetor 2030]; dhe
5. do të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar përfundimin me sukses të pjesës 1 të Projektit.

b) Dispozitat e seksionit 4.02 (*Përgjegjësitë në lidhje me ekzekutimin e Projektit*) të termave dhe kushteve standarde do të zbatohen sikur të parashikohen këtu plotësisht, *mutatis mutandis*, duke përfshirë pa cenuar përgjithësinë e tyre, sikur:

- i. referencat për “Huamarrësin” të lexoheshin si referenca për “Sovranin”; dhe
- ii. referencat për “të ardhurat e Huas” të lexoheshin si referenca për “të ardhurat e financimit të Grantit”.

Seksioni 3.03 Pajtueshmëria mjedisore dhe sociale

Me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, Subjekti i Projektit do të garantojë që pjesa e Projektit e financuar me financimin e Grantit të kryhet në përputhje me seksionin [2.05] (*Konventat e pajtueshmërisë mjedisore dhe sociale*) të Marrëveshjes së Projektit.

Seksioni 3.04 Detyrimet për mbështetje të Sovranit

a) Sovrani nuk do të ndërmarrë asnjë veprim, as nuk do të lejojë asnjë nga agjentët ose filialet e tij që të ndërmarrin ndonjë veprim që do të pengonte ose ndërhynte në ekzekutimin e pjesës 1 të Projektit ose në funksionimin e efektshëm të objekteve të Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të Subjektit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit. Sovrani do të garantojë gjithashtu që asnjë veprim i tillë të mos ndërmerret ose të lejohet të ndërmerret nga asnjë prej nënndarjeve të tij politike ose administrative ose ndonjë prej subjekteve që zotërohen dhe kontrollohen nga, ose që veprojnë në emër ose përfitim të Sovranit ose nënndarjeve të tilla.

b) Sovrani, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

1. do të kryejë siç duhet të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas Marrëveshjes së Huas;

2. do të mbështesë Subjektin e Projektit për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit, duke përfshirë marrjen e të gjitha veprimeve legjislative, rregullatore ose të tjera të nevojshme ose të dëshirueshme, dhe duke alokuar dhe provuar, ose marrë masa që të sigurohen fonde dhe mbështetje për Subjektin e Projektit sipas dhe kur nevojitet nga Subjekti i Projektit për të përfunduar pjesën 1 të Projektit; dhe

3. do të ekzekutojë çdo dokument tjetër dhe do të ndërmarrë çdo veprim tjetër që Banka çmon se janë të nevojshme ose të dëshirueshme për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.05 Njësia e Zbatimit të Projektit

Subjekti i Projektit do të garantojë që aktivitetet dhe përgjegjësitë e NJZP-së, të përmendura në seksionin [2.03] (*Njësia e Zbatimit të Projektit*) të Marrëveshjes së Projektit, përfshijnë prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti dhe zbatimin e financimit të Grantit.

Neni 3.06 Prokurimi

a) Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, prokurimi i të gjithë Zërave të Financuar nga Granti do të rregullohet nga rregullat e prokurimit të BERZH-it.

b) Mallrat, punët dhe shërbimet, si dhe shërbimet e konsulencës do të prokurohen përmes procedurave të hapura konkurruese.

c) Për qëllimet e seksionit 2.04(a), procedurat për procedurat e hapura konkurruese përcaktohen në seksionin III të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

d) Të gjitha kontratat do t'i nënshtrohen procedurave të rishikimit të përcaktuara në rregullat e prokurimit të BERZH-it dhe do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka.

Subjekti i Projektit pranon që politikat dhe rregullat e prokurimit të BERZH-it, të datës 15 maj 2022 (të ndryshuar herë pas here), do të jenë rregullat e zbatueshme të prokurimit të BERZH-it.

Seksioni 3.07 Dokumentet dhe raportet e projektit; kontrollet

a) Subjekti i Projektit do të sigurojë që informacioni që i jep Bankës dhe dokumentet e mbajtura nga Subjekti i Projektit, në përputhje me detyrimet e Subjektit të Projektit në bazë të seksionit [2.07] (*Kërkesat e shpeshtësisë së raportimit dhe paraqitjes*) dhe seksionit 3.01(b) (*Dokumentet dhe raportet financiare*) të Marrëveshjes së Projektit, si dhe seksionit 4.04 (*Dokumentet dhe raportet financiare*) dhe seksionit 5.02 (*Raportimi*) i termave dhe kushteve standarde:

1. përfshin informacion të detajuar në lidhje me kontratat, kontraktorët, disbursimet, financimin e Grantit dhe përdorimin e tij, Zërat e Financuar nga Granti, si dhe statusin e përputhshmërisë me secilin prej angazhimeve të përfshira në këtë Marrëveshje, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

2. përmban informacion të mjaftueshëm për të mundësuar gjurmimin e financimit të Grantit të dallueshëm nga financimi i Huas; dhe

3. përfshin informacione të tjera në lidhje me, *ndër të tjera*, Subjektin e Projektit, pjesën 1 të Projektit dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

b) Sapo të jetë e disponueshme, por në çdo rast, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të kontratës së fundit, Subjekti i Projektit do t'i japë Bankës (nëse kërkohet nga Banka, e vërtetuar nga përfaqësuesi i autorizuar i Subjektit të Projektit) një raport përfundimtar në lidhje me përdorimin e financimit të Grantit, i cili do të specifikojë hollësisht të gjitha kontratat, të gjithë kontraktorët, Zërat e Financuar nga Granti dhe skedulet e dorëzimit dhe vendosjes, dhe krahasimin me parashikimet origjinale.

c) Sapo të jetë e mundur, por në çdo rast, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas datës së përfundimit të Projektit, Subjekti i Projektit do t'i dorëzojë Bankës (nëse kërkohet nga Banka, e vërtetuar nga përfaqësuesi i autorizuar i Subjektit të Projektit) një raport përfundimtar në lidhje me pjesën 1 të Projektit, me anë të së cilës identifikohet përdorimi i financimit të Grantit.

d) Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit duhet dhe do të marrin masa që Kontraktori të lejojë Bankën, Komisionin Evropian, OLAF-in, Gjykatën Evropiane të Audituesve ose cilindo prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar të kryejnë rishikime në zyrë dhe kontrole në vend mbi përdorimin e Financimit të Grantit. Për këtë qëllim, secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit do t'i mundësojë Bankës, Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve ose çdo përfaqësuesi të tyre të autorizuar, sipas kërkesës:

1. të vizitojnë çdo objekt dhe kantier ndërtimi në lidhje me pjesën 1 të Projektit, si dhe çdo ambient ku zhvillohet biznesi i Subjektit të Projektit;

2. të kontrollojnë çdo dhe të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e financimit të Grantit dhe çdo impiant, instalim, vendndodhje, punë, ndërtesa, pronë, pajisje, të dhënat dhe dokumente që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të Sovranit sipas kësaj Marrëveshjeje;

3. të kenë akses dhe të kontrollojnë çdo dhe të gjitha llogaritë, regjistrimet, dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara të Sovranit dhe Subjektit të Projektit që lidhen me financimin e Grantit dhe të lejojnë që këto dokumente dhe llogari të auditohen nga Banka ose përfaqësuesit e saj; dhe

4. për këto qëllime, të takohen dhe të zhvillojnë diskutime me përfaqësues dhe punonjës të Subjektit të Projektit që Banka mund t'i çmojë të nevojshme dhe të përshtatshme.

e) Me dhënien e çdo kontrate, Banka mund të publikojë një përshtatje të saj, emrin dhe kombësinë e Kontraktorit dhe çmimin e kontratës.

f) Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit do të garantojë që Banka, Fondi dhe përfaqësuesit e tij të marrin akses në të gjithë librat e llogarive, regjistrimet, dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara të Sovranit dhe Subjektit të Projektit në lidhje me pjesën 1 të Projektit dhe financimit të Grantit dhe që këta libra të llogarive, regjistrimet, dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara depozitohen në një mënyrë që mundëson në mënyrë të arsyeshme auditimin dhe kontrollin, siç parashikohet në seksionin [3.07(c)].

g) Subjekti i Projektit duhet dhe do të marrë masa që Kontraktori të njoftojë menjëherë Bankën nëse Sovrani ose Subjekti i Projektit ose Kontraktori konsiderojnë ose marrin dijeni se ka ndodhur ose mund të ndodhë një ngjarje që do të ndikojë ose vonojë zbatimin e pjesës së pjesës 1 të projektit të financuar nga financimi i Grantit në ndonjë aspekt material.

h) Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit do të njoftojë menjëherë Bankën nëse Sovrani ose Subjekti i Projektit merr ndonjë informacion në lidhje me shkeljen e seksionit [4.06] (*Mashtrim dhe korrupsion*) të kësaj Marrëveshjeje, ose ka dyshim të besueshëm për ekzistencën e praktikave të ndaluara dhe/ose çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm në lidhje me pjesën 1 të Projektit që mund të ndikojë në interesat financiare të Fondit. Nëse BERZH-i njofton Sovranin ose Subjektin e Projektit për shqetësimin e tij se ka pasur shkelje të këtij seksioni [4.05] (*Mashtrimi dhe korrupsioni*) të kësaj

Marrëveshjeje, Sovrani ose Subjekti i Projektit sipas rastit, do të bashkëpunojë në mirëbesim me Bankën dhe përfaqësuesit e saj për të përcaktuar nëse një shkelje e tillë ka ndodhur.

i) Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit do t'i japë Bankës menjëherë informacionin që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

j) Nëse kërkohet nga Banka, secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit do të sigurojë menjëherë prova dokumentuese që mbështesin përfaqësimin dhe garancinë e dhënë sipas seksionit [8.08] (*Përfaqësimet – Praktikat e ndaluara dhe Subjekti i Përfjashtuar*).

Seksioni 3.08 Dhënia e Grantit

a) Sovrani do të vërë në dispozicion të ose për përfitimin e Subjektit të Projektit, të ardhurat e financimit të Grantit me kushte tregtare jo më pak të favorshme për Subjektin e Projektit, në çdo aspekt material, sesa ato sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Subjekti i Projektit dhe Sovrani do të garantojnë që Subjekti i Projektit të përdorë të gjitha të ardhurat e financimit të Grantit të marrë nga Sovrani ekskluzivisht në përputhje me seksionin 2.01(b) dhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV

Bashkëpunimet financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01 Dokumentet dhe raportet financiare

a) Subjekti i Projektit do të mbajë dokumente dhe llogari të veçanta në lidhje me financimin e Grantit, në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranueshme për Bankën dhe të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme.

b) Subjekti i Projektit do të sigurojë që informacioni i dhënë Bankës nga Subjekti i Projektit dhe dokumentet e mbajtura nga Subjekti i Projektit, në përputhje me detyrimet e Subjektit të Projektit në bazë të seksionit [3.01] (*Dokumentet dhe raportet financiare*) të Marrëveshjes së Projektit, si dhe seksionit 5.02(c)(i) (*Raportimi*) të termave dhe kushteve standarde:

1. përfshin informacion të detajuar në lidhje me financimin e Grantit dhe përdorimin e tij, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

2. përmban informacion të mjaftueshëm për të mundësuar gjurmimin e financimit të Grantit të ndryshëm nga financimi i Huas; dhe

3. përfshin informacione të tjera në lidhje me dokumentet, llogaritë dhe pasqyrat financiare që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

c) Subjekti i Projektit, të paktën deri 5 (pesë) vjet pas datës së përfundimit të projektit:

1. do të mbajë dokumente dhe regjistrime të kontabilitetit financiar në lidhje me aktivitetet e financuara nga financimi i Grantit; dhe

2. do të vendosë në dispozicion të Bankës, sipas kërkesës, të gjithë informacionin financiar përkatës, duke përfshirë pasqyrat e llogarive, në lidhje me pjesën 1 të Projektit.

d) Sovrani dhe Subjekti i Projektit duhet dhe do të marrin masa që Kontraktori të mbajë të gjithë informacionin financiar përkatës, dokumentet dhe llogaritë në lidhje me financimin e Grantit për të identifikuar çdo dhe të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e financimit të grantit dhe të identifikojë përdorimin e tyre në pjesën 1 të Projektit, për jo më pak se pesë vjet pas datës së fundit:

1. të datës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje; dhe

2. nëse një auditim ose hetim është iniciuar nga OLAF-i ose Banka në lidhje me pjesën 1 të Projektit, data e përfundimit të këtij auditimi ose hetimi;

dhe Sovrani dhe Subjekti i Projektit duhet dhe do të marrin masa që Kontraktori t'i vendosë këto informacione, dokumente dhe llogari në dispozicion për përfaqësuesit e Bankës, me kërkesë të Bankës.

Seksioni 4.02 Kryerja e biznesit dhe veprimeve

Subjekti i projektit, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të kryejë siç duhet të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit;

b) nuk do të shesë, japë me qira ose disponojë në ndonjë mënyrë tjetër asnjë nga asetet e tij thelbësore që kërkohen për kryerjen efikase të veprimeve të tij ose disponimi i të cilave mund të cenojë aftësinë e tij për të përmbushur në mënyrë të pranueshme ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) nuk do të bëjë ndryshime ose të lejojë që të bëhen ndryshime në Statutet e tij, përveç ndryshimeve që rrjedhin nga riorganizimet e planifikuara në pajtim me ligjin nr. 142/2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i datës dhjetor 2016 dhe ligjin nr. 90/2021, “Për ndarjen e Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., të datës korrik 2021, dhe me kusht që në secilin rast, këto ndryshime të mos jenë në mospërputhje me ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje dhe të mos dëmtojnë aftësinë e Subjektit të Projektit për të përmbushur kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe

d) do të ekzekutojë çdo dokument tjetër dhe ndërmarrë çdo veprim tjetër që Banka çmon se janë të nevojshme ose të dëshirueshme për t’i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03 Taksat

a) Subjekti i Projektit do të paguajë, në kohën e duhur, të gjitha taksat që i janë vendosur dhe të pagueshme mbi ose në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë dispozitën e financimit të Grantit) ose ndonjë dokument tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Asnjë pjesë e të ardhurave të financimit të Grantit nuk do të përdoret, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për pagimin e ndonjë takse, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në territorin e Sovranit apo diku tjetër.

Seksioni 4.04 Vizibiliteti

a) Sovrani dhe Subjekti i Projektit do të marrin masat e duhura për të publikuar në publikime, komunikimet përkatëse, si dhe në media, faktin që pjesa 1 e Projektit ka marrë financim nga, ndër të tjera, Fondi.

b) Sovrani dhe Subjekti i Projektit do të sigurojnë që çdo raport specifik ose çdo produkt tjetër, i përgatitur në lidhje me pjesën 1 të Projektit, të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të (emrit të autorit) dhe për këtë arsye në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë opinionin zyrtar të kontribuesve në Fondin e Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor ose BERZH-it ose EIB-it, si bashkëmenaxherë të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor”.

c) Sovrani dhe Subjekti i Projektit do të bashkëpunojnë plotësisht në mirëbesim me Bankën dhe do të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura, me qëllim që të bien dakord për një plan komunikimi në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

Seksioni 4.05 Mashtrimi dhe korrupsioni

Sovrani dhe Subjekti i Projektit nuk duhet dhe nuk do të autorizojnë ose lejojnë asnjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, filialet, agjentët ose përfaqësuesit e tyre që të angazhohen në ndonjë praktikë të ndaluar dhe/ose ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që mund të ndikojë në interesat financiare të Fondit në lidhje me pjesën 1 të Projektit, financimin e Grantit ose çdo transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje (duke përfshirë kontratat dhe Zërat e Financuar nga Granti). Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, Sovrani dhe Subjekti i Projektit pranojnë se Banka mund të nxisë politikat dhe procedurat e zbatimit në lidhje me pretendimet e praktikave të ndaluara në lidhje me pjesën 1 të Projektit, financimin e Grantit dhe transaksionet e parashikuara me këtë Marrëveshje.

Seksioni 4.06 Puna e fëmijëve

Sovrani do të sigurojë që Subjekti i Projektit dhe pjesa 1 e Projektit janë në çdo kohë në përputhje me kërkesat në lidhje me punën e fëmijëve ose trafikimin e qenieve njerëzore siç përcaktohet në politikën mjedisore dhe sociale të BERZH-it, veçanërisht në kërkesën e performancës 2: Puna dhe kushtet e punës.

Neni V

Pezullimi dhe anulimi; kompensimi

Seksioni 5.01 Pezullimi

a) Nëse ndonjë nga rastet e mëposhtme ka ndodhur dhe vazhdon, Banka, me njoftim drejtuar Sovranit dhe Subjektit të Projektit, mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Sovranit për disbursim të mëtejshëm sipas kësaj Marrëveshjeje:

1. Marrëveshja e Huas ose Marrëveshja e Projektit pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë ose përfundon;

2. Sovrani ose Subjekti i Projektit nuk ka përmbushur ose nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Projektit, nëse është e zbatueshme, Marrëveshjes së Grantit të Investimeve WBIF - pjesa 2 ose Marrëveshjeve të Grantit TC;

3. Provohet se financimi alternativ është marrë për financimin e pjesës 1 të Projektit, duke sjellë në këtë mënyrë, financimin e dyfishtë (qoftë tërësisht ose pjesërisht);

4. Banka ka pezulluar ose ka ndodhur një rast që i jep Bankës të drejtën të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtën e Sovranit në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas që të bëjë aplikime për tërheqje, në përputhje me seksionin 7.01 (*Pezullimi*) të termave dhe kushteve standarde ose seksionin [4.01] (*Pezullimi*) të Marrëveshjes së Huas;

5. Banka ka anuluar ose ka ndodhur një rast që i jep Bankës të drejtën të anulojë, tërësisht ose pjesërisht, financimin e Huas në përputhje me seksionin 7.02 (*Anulimi nga Banka*) të termave dhe kushteve standarde;

6. Ka ndodhur ose po vazhdon ndonjë rast i specifikuar në seksionin 7.06 (*Rastet e përshpejtimit*) të termave dhe kushteve standarde ose seksionin [4.02] (*Përshpejtimi i maturimit*) të Marrëveshjes së Huas dhe Banka ka deklaruar të gjitha ose ndonjë pjesë të financimit të Huas që duhet të jetë i kërkueshëm dhe i pagueshëm në përputhje me seksionin 7.06 (*Rastet e përshpejtimit*) të termave dhe kushteve standarde;

7. Është krijuar një situatë e jashtëzakonshme si rezultat i rasteve që kanë ndodhur të cilat do ta bëjnë të pamundur që pjesa 1 e Projektit të mund të kryhet ose Subjekti i Projektit ose Sovrani të mund të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Projektit;

8. Një përfaqësim i bërë nga Subjekti i Projektit ose Sovrani në lidhje me këtë Marrëveshje, të ketë qenë i pasaktë ose mashtrues në çfarëdo aspekti material;

9. Statutet e Subjektit të Projektit të jenë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë në një mënyrë që do të ndikonte në pjesën 1 të Projektit ose aftësinë e Subjektit të Projektit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas dokumenteve të transaksionit në të cilat është palë;

10. Kontrolli i Subjektit të Projektit t'i jetë transferuar një pale përveç Sovranit;

11. Sovrani, në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas, ka anuluar tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të financimit të Huas në përputhje me seksionin 3.08 (*Anulimi*) të termave dhe kushteve standarde;

12. Fondi ka përfunduar në bazë të kushteve të përgjithshme të Fondit, ose njoftimi për përfundimin është dhënë në përputhje me kushtet e përgjithshme të Fondit;

13. Në përputhje me politikën dhe procedurat e zbatimit, Banka ka vendosur që Sovrani, Subjekti i Projektit, një Kontraktor, një filial i këtyre subjekteve ose ndonjë nga zyrtarët, punonjësit, agjentët ose përfaqësuesit e tyre, është përfshirë në listën e personave ose subjekteve të Bankës që nuk kanë të drejtë të marrin një kontratë të financuar nga Banka ose për financim nga Banka, siç një listë e tillë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës;

14. Kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin hekurudhor dhe të transportit në territorin e Sovranit të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë në një mënyrë që ka ose mund të ketë ndikim negativ në pjesën 1 të Projektit ose aftësinë e Sovranit ose Subjektit të Projektit për të përmbushur detyrimet e tij përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit të Investimeve WBIF - pjesa 2 (nëse është e zbatueshme), Marrëveshjes(ve) së Grantit për Punimet e Mbikëqyrjes TC dhe Mbështetjen e Zbatimit të Projektit, Marrëveshjes së Grantit LALRP TC dhe/ose Marrëveshjes së Grantit MOP/FPSC TC, përveç atyre të miratuara me shkrim nga Banka;

15. Ka ndodhur ose mund të ndodhë ndonjë rast që, sipas opinionit të arsyeshëm të Bankës, mund të ndikojë ose vonojë zbatimin e pjesës së pjesës 1 të Projektit të financuar nga financimi i Grantit në çdo aspekt material.

b) E drejta e Sovranit për ndonjë disbursim të mëtejshëm do të vijojë të pezullohet tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa rasti ose rastet që shkaktuan pezullimin të kenë pushuar së ekzistuari, përveç nëse Banka të ketë njoftuar Sovranin se e drejta për disbursime të mëtejshme është rikthyer; megjithatë, me kusht që e drejta për disbursime të mëtejshme të rikthehet vetëm në masën dhe në bazë të kushteve të specifikuara në këtë njoftim, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose cenojë asnjë të drejtë, tagër ose mjet juridik të Bankës në lidhje me ndonjë rast tjetër të mëvonshëm të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 5.02 Anulimi nga Banka

a) Nëse në ndonjë moment Banka vendos, pas konsultimit me Sovranin dhe Subjektin e Projektit, se nuk do të kërkohet një shumë e financimit të Grantit për të financuar kostot e pjesës 1 të Projektit që do të financohet nga financimi i Grantit, Banka, duke njoftuar Sovranin dhe Subjektin e Projektit, mund të anulojë një shumë të tillë të financimit të Grantit. Në datën e fundit të disponueshmërisë së financimit të Grantit, çdo pjesë e padisbursuar e financimit të Grantit do të anulohet automatikisht, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe.

b) Nëse e drejta e Sovranit për disbursimin e ndonjë pjese të financimit të Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë pezulluar në përputhje me seksionin 5.01 (*Pezullimi*) të kësaj Marrëveshjeje për një periudhë të pandërprerë prej 30 (tridhjetë) ditësh, Banka mund të anulojë financimin e Grantit, tërësisht ose pjesërisht, duke njoftuar Sovranin dhe subjektin e projektit.

c) Nëse Banka ka anuluar ose ka ndodhur një rast që i jep Bankës të drejtën të anulojë, tërësisht ose pjesërisht financimin e Huas në përputhje me seksionin 7.02 (*Anulimi nga Banka*) të termave dhe kushteve standarde, Banka mund të anulojë financimin e Grantit, tërësisht ose pjesërisht, duke njoftuar Sovranin dhe Subjektin e Projektit.

d) Nëse në çdo kohë, Banka vendos, se:

1. prokurimi i ndonjë prej Zërave të Financuar nga Granti nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje;

2. fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje; ose

3. në lidhje me ndonjë kontratë, çdo përfaqësues i Sovranit, Subjektit të Projektit ose Kontraktori është angazhuar në ndonjë praktikë të ndaluar gjatë prokurimit ose ekzekutimit të kësaj kontrate, ku Sovrani, Subjekti i Projektit nuk kanë marrë veprimet e duhura dhe në kohë të pranueshme për Bankën për të korrigjuar situatën;

Banka, duke njoftuar Sovranin dhe Subjektin e Projektit, mund të anulojë plotësisht ose pjesërisht financimin e Grantit. Një anulim i tillë do të hyjë në fuqi kur të jepet njoftimi.

e) Nëse në çdo kohë, në përputhje me politikën dhe procedurat e zbatimit, Banka vendos se ndonjë përfaqësues i Sovranit, Subjektit të Projektit, çdo Kontraktori, një filial i subjekteve të tilla, ose ndonjë prej zyrtarëve, punonjësve, agjentëve ose përfaqësues të tyre, është përfshirë në listën e personave ose subjekteve të Bankës që nuk kanë të drejtë të fitojnë një kontratë të financuar nga Banka ose për financim nga Banka, siç kjo listë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës, anulojnë financimin e Grantit tërësisht ose pjesërisht. Një anulim i tillë do të hyjë në fuqi kur të jepet njoftimi.

Seksioni 5.03 Angazhimet e rimbursimit të pakushtëzuar, të paprekur nga pezullimi ose anulimi

Asnjë anulim ose pezullim nuk do të zbatohet për shumat që i nënshtrohen një angazhimi rimbursimi të pakushtëzuar të lidhur nga Banka në përputhje me seksionin 2.03 (*Angazhimet e rimbursimit të kushtëzuar dhe të pakushtëzuar*) të kësaj Marrëveshjeje, përveç siç parashikohet shprehimisht në një angazhim të tillë.

Seksioni 5.04 Detyrimet e Sovranit dhe Subjektit të Projektit

Pavarësisht nga ndonjë anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vijojnë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç rasteve të parashikuara specifikisht këtu.

Seksioni 5.05 Rastet e rimbursimit

Nëse do të ketë ndodhur ndonjë nga rastet e mëposhtme dhe, nëse është e zbatueshme, do të vijojë për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo kohë gjatë vazhdimit të atij rasti, Banka, me njoftim drejtuar Sovranit dhe Subjektit të Projektit, mund të kërkojë që Sovrani dhe Subjekti i Projektit të rimbursojnë të gjithë ose ndonjë pjesë të financimit të Grantit (dhe paguan çdo shumë tjetër të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje) dhe më pas kjo do të bëhet (çdo gjë në këtë Marrëveshje, pavarësisht nga e kundërta), menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme:

- a) ka ndodhur ndonjë rast i specifikuar në seksionin 5.01(a)(1) (*Pezullimi*) të kësaj Marrëveshjeje;
- b) ka ndodhur ndonjë rast i specifikuar në seksionin 5.01(a)(2) (*Pezullimi*) të kësaj Marrëveshjeje dhe, nëse mund të korrigjohet, ka vijuar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit të dhënë nga Banka;
- c) ka ndodhur ose po vazhdon ndonjë rast përsheptimi i specifikuar në termat dhe kushtet standarde dhe Marrëveshjen e Huas dhe Banka ka deklaruar të gjithë ose ndonjë pjesë të financimit të Huas si të kërkueshme dhe të pagueshme në përputhje me seksionin 7.06 (*Rastet e përsheptimit*) të termave dhe kushteve standarde;
- d) në çdo kohë, në përputhje me politikën dhe procedurat e zbatimit, Banka vendos që Sovrani, Subjekti i Projektit, ndonjë Kontraktues, një filial i këtyre subjekteve, ose ndonjë nga zyrtarët, punonjësit, agjentët ose përfaqësuesit e tyre, ka qenë i përfshirë në listën e personave ose subjekteve të Bankës që nuk kanë të drejtë të marrin një kontratë të financuar nga Banka ose për financim nga Banka, siç një listë e tillë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës;
- e) Sovrani, në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas, ka anuluar tërësisht ose pjesërisht ndonjë pjesë të padisbursuar të financimit të Huas në përputhje me seksionin 3.08 (*Anulimi*) të termave dhe kushteve standarde;
- f) burimet e Fondit janë paguar në mënyrë të padrejtë ose janë përdorur gabimisht nga Sovrani ose Subjekti i Projektit, me kusht që shuma që do të rimburohet do të jetë ajo pjesë e financimit të Grantit që është përdorur në mënyrë të padrejtë ose gabimisht;
- g) ka ndodhur ose mund të ndodhë ndonjë rast që, sipas opinionit të arsyeshëm të Bankës, mund të ndikojë ose vonojë zbatimin e pjesës së pjesës 1 të Projektit të financuar nga financimi i Grantit në çdo aspekt material;

h) Banka do të ketë vendosur që ose Sovrani, ose Subjekti i Projektit janë përfshirë në një praktikë të ndaluar ose aktivitet tjetër të paligjshëm në lidhje me përdorimin e financimit të Grantit dhe/ose zbatimin e pjesës 1 të Projektit.

Seksioni 5.06 Rikuperimi

a) Banka do të ketë të drejtën të rikuperojë të gjitha ose ndonjë pjesë të burimeve të Fondit në rrethanat e mëposhtme:

i. nëse Banka ka vendosur në përputhje me politikat dhe procedurat e zbatimit të Bankës që Sovrani ose Subjekti i Projektit janë përfshirë në një praktikë të ndaluar; ose

ii. nëse Sovrani ose Subjekti i Projektit nuk është në përputhje me kushtet e Marrëveshjes ose burimet e Fondit janë keqpërdorur nga Sovrani ose Subjekti i Projektit.

b) Nëse Banka, në përputhje me politikat dhe procedurat e saj, ose Komisioni Evropian, OLAF-i ose Gjykata Evropiane e Audituesve, në përputhje me seksionin 3.07(c) të kësaj Marrëveshjeje vendosin se burimet e Fondit kanë qenë të keqpërdorura nga Sovrani ose Subjekti i Projektit, Banka do të marrë të gjitha masat e zbatueshme në përputhje me politikat dhe procedurat e saj të zbatueshme për të rikuperuar ato fonde.

Neni VI

Zbatueshmëria, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 6.01 Zbatueshmëria

Të drejtat dhe detyrimet e Sovranit dhe Subjektit të Projektit do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga ndonjë ligj vendas për të kundërtën. Sovrani dhe Subjekti i Projektit nuk do të kenë të drejtë në asnjë rrethanë të pretendojë se ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e pazbatueshme për ndonjë arsye.

Seksioni 6.02 Mospërbushja e të drejtave

Asnjë vonesë në ushtrimin, ose mosveprim për të ushtruar ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik që i krijohet secilës palë sipas kësaj Marrëveshjeje në rast mospërbushjeje, nuk do të cenojë këtë të drejtë, fuqi ose mjet juridik ose do të interpretohet si heqje dorë prej tij ose pranim i heshtur në këtë mospërbushje; as veprimi i kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërbushje, ose pranim në ndonjë mospërbushje, nuk do të ndikojë ose cenojë ndonjë të drejtë, tagër ose mjet juridik të kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërbushje tjetër të mëvonshme.

Neni 6.03 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Dispozitat e seksionit 8.04 (*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*) të termave dhe kushteve standarde do të zbatohen sikur të përcaktohen këtu plotësisht *mutatis mutandis*, me përjashtim, kur:

i. referencat për “Marrëveshjen e Huas” ose “Marrëveshjen e Projektit” të lexoheshin si referenca për “këtë Marrëveshje”; dhe

ii. referencat për “Huamarrësin” të lexoheshin si referenca për “Sovranin”.

Neni VII

Hyrja në fuqi; përfundimi

Seksioni 7.01 Data e hyrjes në fuqi

Me përjashtim të rastit kur Banka, Sovrani dhe Subjekti i Projektit bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Banka i dërgon Sovranit dhe Subjektit të Projektit njoftimin për pranimin nga Banka të provave të kërkuara nga seksioni [7.02] (*Kushtet para hyrjes në fuqi*) dhe seksioni [7.03] (*Opinionet ligjore*) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.02 Kushtet para hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi nëse Banka nuk është e bindur se nuk ka ndodhur dhe nuk po vijon asnjë rast i përmendur në seksionin [5.01(a)] (*Peçullimi*) ose seksionin [5.05] (*Raste të rimbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje; dhe deri kur të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme pararendëse, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, ose sipas gjykimit të Bankës, është hequr dorë, tërësisht ose pjesërisht dhe nëse i nënshtrohet kushteve ose pa kushte:

a) Banka të ketë marrë dy origjinale të ekzekutuara siç duhet të kësaj Marrëveshjeje;

b) të gjitha kushtet para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Huas sipas seksionit 9.02 (*Kushtet para hyrjes në fuqi*) të termave dhe kushteve standarde dhe seksionit [5.01] (*Kushtet para hyrjes në fuqi*) të Marrëveshjes së Huas, përveçse vetëm hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

c) Banka të ketë marrë nga Sovrani njoftim me shkrim lidhur me përfundimin e të gjitha procedurave që kërkohen për hyrjen në fuqi dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, me anë të së cilës konfirmohet miratimi i kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe publikimi i këtij vendimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, dhe se janë zbatuar të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar për sigurimin e vlefshmërisë dhe zbatueshmërisë së kësaj Marrëveshjeje.

d) Banka të ketë marrë nga Subjekti i Projektit prova, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje nga Subjekti i Projektit është autorizuar siç duhet nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare, administrative dhe korporative;

e) Kushtet e përgjithshme të Fondit kanë hyrë në fuqi në përputhje me kushtet e tij; dhe

f) Bankës i janë dhënë dokumente të tjera që mund të ketë kërkuar në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 7.03 Opinioni ligjor

Si pjesë e provave që duhet të sigurohen në bazë të seksionit 7.02 (*Kushtet para hyrjes në fuqi*) të kësaj Marrëveshjeje, Subjekti i Projektit do t'i japë ose marrë masa që Bankës t'i jepet një opinion në emër të Subjektit të Projektit nga këshilltari i brendshëm i Subjektit të Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe duke provuar se kjo Marrëveshje ka qenë e autorizuar siç duhet ose ratifikuar, ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Subjektit të Projektit, dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish të detyrueshëm të Subjektit të Projektit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

Seksioni 7.04 Kushtet shitesë para disbursimit

Pa cenuar seksionin 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, detyrimi i Bankës për të kryer disbursimin e parë të Grantit do t'i nënshtrohet përmbushjes paraprake, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, ose sipas gjykimit të vetëm të Bankës, heqja dorë, qoftë tërësisht apo pjesërisht dhe nëse i nënshtrohen kushteve apo të pakushtëzuara, të kushteve paraprake të mëposhtme të përcaktuara në seksionin 5.02 (*Kushtet para tërheqjes së parë të transhit të Huas A*) dhe seksionin 5.03 (*Kushtet shitesë para tërheqjeve së transhit të Huas A*) të Marrëveshjes së Huas.

Seksioni 7.05 Përfundimi për moshyrjen në fuqi

Nëse:

a) kjo Marrëveshje nuk do të ketë hyrë në fuqi deri në datën e cila është 180 ditë nga data e kësaj Marrëveshjeje; ose

b) Marrëveshja e Huas nuk do të ketë hyrë në fuqi deri në datën e specifikuar në seksionin 5.06 (*Përfundimi për moshyrjen në fuqi*) të Marrëveshjes së Huas ose ndonjë datë tjetër të njoftuar nga Banka te Sovrani në cilësinë e saj si Huamarrës, në përputhje me seksionin 9.04 (*Përfundimi për moshyrjen në fuqi*) të termave dhe kushteve standarde;

të gjitha detyrimet e Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojnë nëse Banka, pas shqyrtimit të arsyeve për vonesën, do të vendosë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni. Banka do të njoftojë menjëherë Sovranin dhe Subjektin e Projektit për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 7.06 Përfundimi për realizimin e përmbushjes

a) Kjo Marrëveshje do të vijojë në fuqi derisa Sovrani dhe Subjekti i Projektit të kenë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre përkatëse në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur përfundon më herët në përputhje me kushtet e saj; me kusht që dispozitat e seksionit 6.03 (*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*) do të vijojnë edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

b) Pavarësisht ndonjë pike për të kundërtën në këtë Marrëveshje, dispozitat e seksionit 5.05(d) (*Rastet e rimbursimit*) do të vijojnë edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje për 5 (pesë) vjet pas datës së përfundimit të Projektit.

Neni VIII Të ndryshme

Seksioni 8.01 Njoftimet

a) Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë me shkrim. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në seksionin 7.01 (*Data e hyrjes në fuqi*) të kësaj Marrëveshjeje, një njoftim ose kërkesë e tillë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë siç duhet kur i është dorëzuar palës së cilës kërkohet t'i jepet ose është bërë në adresën e palës të specifikuar më poshtë ose në një adresë tjetër që kjo palë duhet t'ia ketë specifikuar me shkrim palës tjetër që jep njoftimin ose bën kërkesën. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje ose në Manualin e Disbursimit të BERZH-it, një dërgesë e tillë mund të bëhet dorazi, me postë ose me faks. Dërgimet e bëra me faks do të konfirmohen gjithashtu me postë.

Për Sovranin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë,
Shqipëri
Në vëmendje të: Ministrisë së Financave
Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për Subjektin e Projektit:

Hekurudha Shqiptare sh.a.
L.NR3, Rr. Egnatia, Durrës
Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të: Ergys Verdho
Email: ergys.verdho@hekurudha.al

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
5 Bank Street
London E14 4BG
United Kingdom
Në vëmendje të: Departamentit të Shërbimeve Bankare/
Veprimi nr. 53468
Telefon: +44 20 7338 6000
Email: bankingservices@ebrd.com

Seksioni 8.02 Autoriteti për të vepruar

Çdo veprim që kërkohet ose lejohet të ndërmerret dhe çdo dokument që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje nga Sovrani ose Subjekti i Projektit, do të ndërmerret ose ekzekutohet nga përfaqësuesi i autorizuar i Sovranit dhe përfaqësuesi i autorizuar i Subjektit të Projektit, sipas rastit, ose zyrtarë të tjerë të Sovranit dhe Subjektit të Projektit, siç do të caktohen me shkrim nga çdo përfaqësues i tillë i autorizuar. Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit do t'i paraqesin Bankës dëshmi të autoritetit dhe nënshkrimin model të autorizuar të këtij zyrtari, kryesisht në formën e shtojcës 2 (*Formulari i letrës me anë të së cilës përcaktohen nënshkruesit e autorizuar*).

Neni 8.03 Ndryshimi

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me një instrument me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Sovranit, përfaqësuesi i autorizuar i Subjektit të Projektit dhe nga një zyrtar i Bankës i autorizuar sipas rregullave.

Seksioni 8.04 Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe ekzekutuar në gjuhën angleze. Çdo dokument i dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje, do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në çdo gjuhë tjetër do të shoqërohen me një përkthim të tyre në anglisht të vërtetuar si një përkthim i miratuar dhe ky përkthim i miratuar do të jetë përfundimtar.

Seksioni 8.05 Zhdëmtimi

a) Sovrani dhe Subjekti i Projektit marrin përgjegjësi të plotë dhe bien dakord dhe do të zhdëmtojnë dhe mbajnë të padëmtuar Bankën dhe zyrtarët, drejtorët, punonjësit, agentët dhe punonjësit ndaj dhe nga ndonjë dhe të gjitha detyrimet, përgjegjësitë, humbjet, dëmet (kompensuese, ndëshkuese ose ndryshe), gjobot, pretendimet, veprimet, taksat, paditë, kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit ligjor dhe shpenzimet e hetimit) të çfarëdo lloji dhe natyre, duke përfshirë, pa cenuar përgjithësinë e sa më sipër, ato që lindin nga kontrata ose dëmshpërblimi (përfshirë pakujdesinë) ose nga përgjegjësia rigoroze ose ndryshe, të cilat janë vendosur, shkaktuar ose pretenduar ndaj Bankës ose ndonjë prej zyrtarëve, drejtorëve, punonjësve, agentëve ose punonjësve të saj (të zhdëmtuar ose jo të zhdëmtuar gjithashtu nga ndonjë person tjetër sipas ndonjë dokumenti tjetër) dhe të cilat në çfarëdo mënyre lidhen ose lindin, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga:

1. ndonjë nga transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje ose ekzekutimi, dorëzimi ose kryerja e saj;
2. funksionimi ose mirëmbajtja e objekteve të Subjektit të Projektit ose pronësia, kontrolli ose zotërimi i tyre nga Subjekti i Projektit; ose
3. ushtrimi nga Banka të cilitdo prej të drejtave dhe mjeteve të saj juridike sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe me kusht që Banka nuk do të ketë asnjë të drejtë të dëmshpërblehet sipas këtij ligji për pakujdesinë e saj të rëndë ose sjelljen e papërshtatshme të qëllimshme.

b) Sovrani dhe Subjekti i Projektit pranojnë se Banka po lidh këtë Marrëveshje dhe ka vepruar vetëm si ofrues i grantit dhe jo si këshilltar, për Sovranin ose Subjektin e Projektit. Sovrani dhe Subjekti i Projektit përfaqësojnë dhe garantojnë se në lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, ata janë angazhuar dhe mbështetur në këshillat që kanë marrë nga këshilltarët e tyre ligjorë, financiarë dhe profesionistë të tjerë dhe ata nuk janë mbështetur dhe nuk do të mbështeten në vijim mbi ndonjë këshillë që u jepet nga Banka.

Seksioni 8.06 Delegimet

Sovrani dhe Subjekti i Projektit nuk mund të delegojnë ose ndryshe transferojnë të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave ose detyrimeve të tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

Seksioni 8.07 Të drejtat, mjetet juridike dhe heqjet dorë

Të drejtat dhe mjetet juridike të Bankës, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të cenohen nga asnjë veprim ose pikë që përveç këtij seksioni, mund të cenojë këto të drejta ose mjete juridike. Asnjë negociatë dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik të Bankës nuk do të cenojë këtë të drejtë, tagër ose mjet juridik ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej tyre. Çdo heqje dorë nga ndonjë prej termave ose kushteve të kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga Banka. Në rast se Banka heq dorë nga një kusht për ndonjë disbursim të financimit të grantit, Sovrani, duke marrë këtë disbursim, do të konsiderohet se ka rënë dakord me kushtet e një heqje dorë të tillë dhe e drejta e Bankës për të kërkuar respektimin e këtij kushti do të ruhet shprehimisht për qëllimet e çdo disbursimi të mëvonshëm. Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe marrëveshjet e tjera të parashikuara këtu janë kumulative dhe nuk do të përjashtojnë asnjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjeti tjetër juridik.

Seksioni 8.08 Përfaqësimet – praktikat e ndaluara dhe subjektet e përjashtuara

Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit bën përfaqësimet dhe garancitë e mëposhtme, të cilat do të çmohen të përsëritura në paraqitjen e çdo kërkesë për disbursim dhe në çdo datë disbursimi, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese në atë kohë:

a) Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit garanton dhe përfaqëson si më poshtë:

i. Subjekti i Projektit nuk është Njësi e Përjashtuar.

ii. As Subjekti i Projektit dhe as ndonjë subjekt ose person me të cilin ai ose Sovrani ka ose pritet të ketë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë kontraktuale në lidhje me zbatimin e pjesës 1 të Projektit dhe që do të merrte financimin e Grantit, nuk është një person i kufizuar.

As Sovrani, as Subjekti i Projektit ose ndonjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, filialet, agjentët ose përfaqësuesit e tyre përkatës nuk kanë kryer apo nuk janë angazhuar në lidhje me pjesën 1 të Projektit, ose në ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje, Praktikë e Ndaluar dhe/ose aktivitet tjetër i paligjshëm që mund të cenojë interesat financiare të Fondit.

Seksioni 8.09 Zbulimi i informacionit

a) Banka mund të zbulojë dokumente, informacione dhe dokumente të tilla në lidhje me Sovranin dhe Subjektin e Projektit, pjesën 1 të Projektit dhe këtë transaksion (përfshirë kopjet e kësaj Marrëveshjeje, çdo dokument tjetër transaksioni dhe çdo marrëveshje tjetër të parashikuar këtu) që Banka e çmon të përshtatshme për çdo qëllim në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje që përfshin Sovranin dhe Subjektin e Projektit, me qëllim ruajtjen ose zbatimin e ndonjë prej të drejtave të Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshje tjetër të parashikuar në këtë mënyrë ose për marrjen/arkëtimin e ndonjë shume që i detyrohet Bankës dhe në lidhje me detyrimet e raportimit ndaj kontribuesve të Fondit dhe në lidhje me detyrimet e tjera të tij në përputhje me kushtet e përgjithshme të Fondit.

b) Secili nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit pranon dhe pajtohet që Bankës i kërkohet të informojë Komisionin Evropian nëse ai, në lidhje me zbatimin e financimit të Grantit:

i. konstaton se Subjekti i Projektit është Njësi e Përjashtuar;

ii. konstaton se Subjekti i Projektit ose çdo përfitues i financimit të Grantit me të cilin Sovrani ose Subjekti i Projektit hyn në marrëdhënie kontraktuale, është një person i kufizuar; ose

iii. konstaton ndonjë praktikë të ndaluar dhe/ose parregullsi në pagesën dhe/ose përdorimin e financimit të Grantit.

Një informacion i tillë mund të përfshihet në sistemin e zbulimit dhe përjashtimit të hershëm dhe të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

Seksioni 8.10 Përgjegjësia e kontribuesve të Fondit

Kontribuesit e Fondit nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për pretendimet e palëve të treta për dëmet që rrjedhin nga zbatimi i pjesës 1 të Projektit të financuar nga burimet e Fondit.

Seksioni 8.11 Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në çdo numër kopjesh, secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje që nga data e shënuar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: Ervin Mete Nënshkrimi

Titulli: Ministër i Financave

HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Nga: _____

Emri: Ergys Verdhio

Titulli: Administrator

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri: Ekaterina Solovova

Titulli: Drejtore e asociuar, drejtuese për Shqipërinë

SHTOJCA 1

ZËRAT E FINANCIMIT TË GRANTIT

Në tabelën e paraqitur në këtë skedul paraqiten Zërat e Financuar nga Granti dhe shuma e Financimit të Grantit të alokuar për secilin Zë të Financuar nga Granti dhe preventivët e Projektit dhe Plani i Financimit.

	Zërat e Financuar nga Granti	Shuma e financimit të Grantit i alokuar në EURO	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1	Kostot e komponentit të infrastrukturës (duke përfshirë kontigjencat) për pjesën 1 të Projektit	125,813,039	100% e shpenzimeve lidhur me Zërat e Financuar nga Granti, duke përjashtuar taksat, me kushtin që shuma totale e Financimit të Grantit nuk tejkalon 50% të kostove të komponentit të infrastrukturës (duke përfshirë kontigjencat) për pjesën 1 të Projektit të ndodhur në atë kohë.

SHTOJCA 1

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

[Për t'u shtypur në letër me kokë të Sovranit]

[Data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

5 Bank Street

London E14 4BG

United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Shërbimeve Bankare

Veprimi nr. 53468 (Komponenti i Grantit)

Kërkesa për disbursim nr. [1]

Lënda: Marrëveshja e Grantit e datës _____ ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Sovrani”), HEKURUDHA SHQIPTARE SHA (“Subjekti i Projektit”) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”).

Ne kërkojmë disbursimin e mëposhtëm në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit të lartpërmendur.

Valuta e Grantit: [EURO]

Valuta e pagesës që kërkohet : [2]

Shuma(t)/valuta e financuar: [3]

Data e vlerës: [4]

E pagueshme ndaj (marrësit të pagesës): [5]

Emri i llogarisë së marrësit të pagesës: [6]

Numri i llogarisë së marrësit të pagesës: [7]

Emri i Bankës së marrësit të pagesës: [8]

Adresa e Bankës së marrësit të pagesës: [9]

Detajet korresponduese të marrësit të pagesës:

Emri i bankës korresponduese: [10]

Adresa: [11]

Emri i llogarisë: [12]

Numri i llogarisë: [13]

Referenca e pagesës: [14]

Adresa e email-it të marrësit të pagesës: [15]

Me anë të kësaj vërtetojmë se nuk kemi kërkuar më parë disbursim nga financimi i Grantit për të mbuluar këto shpenzime. Ne nuk kemi marrë dhe nuk synojmë të marrim fonde për këtë qëllim nga të ardhurat e ndonjë granti, kredie ose huaje tjetër.

Mallrat dhe shërbimet e mbuluara nga kjo kërkesë janë blerë ose po blihen në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Grantit.

I konfirmojmë BERZH-it, se: (i) raporti i shumës së financimit të Huas me shumën e financimit të Grantit të disbursuar, ose të kërkuar sipas këtij aplikimi për disbursim është []:[] [*Shënim. Shifra duhet të jetë të paktën 40:60.*]; dhe (ii) shuma e financimit të Grantit të disbursuar ose të kërkuar sipas këtij aplikimi për disbursim është e barabartë me [] % të kostove totale që lidhen me komponentin e infrastrukturës të pjesës 1 të Projektit (siç përcaktohet në paragrafin 2(A)(a) të skedulit 1 (*Përshkrimi i Projektit*) të Marrëveshjes së Huas) [*Shënim. Shifra duhet të jetë më e vogël se 50%.*].

I konfirmojmë BERZH-it se përfaqësimet dhe garancitë e bëra nga Sovrani dhe Subjekti i Projektit në seksionin 8.08 (*Përfaqësimet – Praktikë e ndaluar dhe subjekti i përjashtuar*) në këtë Marrëveshje dhe që konsiderohen të përsëritura në datën e kësaj marrëveshjeje, janë të vërteta në dhe që nga data e saj, me të njëjtin efekt sikur përfaqësimet dhe garanci të tilla të ishin bërë në dhe që nga data e kësaj Marrëveshjeje.

I konfirmojmë BERZH-it, se: (i) jemi në pajtim me detyrimet tona, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Grantit dhe Marrëveshjen e Huas; dhe (ii) se nuk ka ndodhur asnjë rast që mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në operacionet ose gjendjen tonë financiare ose aftësinë tonë për të realizuar Pjesën 1 të Projektit ose për të kryer ndonjë nga detyrimet tona sipas Marrëveshjes së Grantit.

Me respekt,

[16]

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Bashkëlidhur: - Numri i përgjithshëm i fletëve përmbledhëse: [17]

- Numri total i zërave në dokument: [18]

Shënime për plotësimin e formularit të kërkesës për disbursim

[1] Sovrani duhet të vendosë numrin në çdo formular kërkesë. Kërkesa e parë për një disbursim granti do të jetë numri 1, kërkesat vijuese do të kenë numrat 2, 3 etj. Sovrani duhet të mbajë shënim numrin e të gjitha kërkesave për disbursim granti që ka bërë sipas marrëveshjes së grantit të dhënë. Formularët e kërkesave duhet të ndjekin të njëjtin sistem numerik sekuencial, qofshin ato për një disbursim të pagesës direkte, ose për lëshimin e një angazhimi rimbursimi. Përdorimi i këtij sistemi numërtimi shmang konfuzionin në rast se formularët mbahen në postim, dërgohen me faks më shumë se një herë etj.

[2] Ju lutem, jepni valutën e pagesës aktuale të kërkuar. Kjo do të jetë ose valuta e grantit, ose valuta e shpenzimeve (shihni [3] më poshtë). Në mënyrë alternative, në disa rrethana Banka mund të pranojë të paguajë në një valutë të tretë, rast në të cilin do të vepronte si agent i Sovranit për të marrë këtë valutë.

Nëse pagesa kërkohet në më shumë se një valutë, atëherë duhet të përdoret një formular tjetër aplikimi për valutë.

[3] Shuma(t) e financuar/a është/janë shpenzimet fillestare në valutën e tyre origjinale siç detajohet në fletën përmbledhëse, të llogaritura në përqindjen e duhur të specifikuar në marrëveshjen e grantit për Zërin e pranueshëm të aplikueshëm të financuar nga Granti. Shumat e dhëna këtu duhet të korrespondojnë me shumën totale në seksionin [15] të fletës përmbledhëse.

[4] Data e vlerës është data kur llogaria e BERZH-it debitohet me shumën e pagesës së disbursimit. BERZH-i nuk mund të garantojë që llogaria e marrësit të pagesës do të kreditohet në të njëjtën datë, pasi kjo varet nga procedurat e miratuara nga sistemi i kleringut ose banka marrëse në vendin e marrësit të pagesës. Duhet të jenë minimumi 15 ditë pune midis datës që BERZH-i merr aplikimin dhe datës së vlerës së kërkuar. Nëse në fakt pagesa nevojitet sa më shpejt që të jetë e mundur, në vend të asaj date specifike të vlerës, mund të jetë më mirë të mos jepet një datë specifike, por të vendoset “sa më shpejt të jetë e mundur” në këtë fushë [4]. Në këtë rast, BERZH-i do të kryejë pagesën në çdo rast brenda 15 ditësh pune, por më herët nëse është e mundur. (Ju lutem, kini parasysh se pagesa mund të garantohej vetëm brenda 15 ditësh pune, nëse kërkesa për disbursim është e saktë dhe e plotë.)

[5] Disbursimi i paguhet marrësit të pagesës. Normalisht marrësi i pagesës do të jetë Kontraktori, por me kusht që Banka të ketë rënë dakord ndryshe me shkrim dhe dokumentacioni bashkëlidhur (shihni fletën përmbledhëse) jep dëshmi se Huamarrësi e ka paguar tashmë Kontraktorin, atëherë pagesa mund t'i bëhet Sovranit.

[6] Emri i llogarisë së marrësit të pagesës në shumicën e rasteve do të jetë thjesht emri i marrësit të pagesës.

[7] Numri i llogarisë së marrësit të pagesës kërkohet për të shmangur vonesat. Në një numër vendesh në rritje, bankat do të refuzojnë të kryejnë pagesën, nëse numri i llogarisë së marrësit nuk jepet në udhëzimet e pagesës.

[8] Banka e marrësit të pagesës është banka ku mbahet llogaria e marrësit të pagesës. Ju lutem, specifikoni emrin e bankës dhe qytetin.

[9] Në vend të adresës, mund të jepet kodi i renditjes ose kodi SWIFT.

[10] Banka korresponduese e bankës së marrësit të pagesës kërkohet vetëm nëse pagesa nuk do të bëhet në valutën e vendit ku ndodhet banka e marrësit të pagesës. Në atë rast, banka korresponduese është banka e vendosur në vendin e valutës së pagesës, në të cilën banka e marrësit të pagesës mban një llogari.

[11] Në vend të një adrese, mund të jepet kodi i renditjes ose kodi SWIFT i bankës korresponduese.

[12] Në shumicën e rasteve, emri i llogarisë së bankës së marrësit të pagesës do të jetë thjesht emri i bankës së marrësit të pagesës.

[13] Numri i llogarisë të bankës së marrësit të pagesës është thelbësor, nëse banka përfituese ka më shumë se një llogari në bankën korresponduese ose nëse nuk është anëtare e SWIFT (sistemi ndërkombëtar i shlyerjes së pagesave elektronike). Përndryshe, ky numër është i dobishëm, por jo i detyrueshëm. Në rastet kur është e zbatueshme, duhet të kuotohet nr. IBAN (numri ndërkombëtar i llogarisë bankare).

[14] Referenca e pagesës që BERZH-i do të dërgojë me pagesën, e ndihmon marrësin e pagesës të identifikojë pagesën. Nëse nuk kërkohet referencë specifike, BERZH-i do të përmendë emrin e Sovranit dhe numrin e marrëveshjes.

[15] Adresa e emailit të marrësit të pagesës është e domosdoshme, në mënyrë që Banka t'i dërgojë marrësit të pagesës njoftime për pagesat e ardhshme përpara se Banka të kryejë pagesa të tilla. Duhet të jetë një llogari emaili që marrësi po e kontrollon rregullisht.

[16] Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkesës duhet të nënshkruhet nga ose në emër të Sovranit.

[17] Fletët përmbledhëse listojnë të gjithë zërat e dokumentacionit të bashkëlidhur për të mbështetur aplikimin e kërkesës për Disbursim. Nëse ka shumë zëra, këshillohet të përdorni një fletë përmbledhëse të veçantë sipas kategorisë.

[18] Zërat e dokumentacionit (kontratat, faturat, dëftesat etj.), duhet të numërtohen dhe të paraqiten në të njëjtin rend, siç paraqiten në fletët përmbledhëse. Numri i tyre total duhet të specifikohet këtu për të lehtësuar rishikimin nga ana e BERZH-it.

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Emri i Sovranit: [1] **Numri i Veprimit:** [3] **Numri i kërkesës:** [4]

Data: [2] **Fleta përmbledhëse Nr.:** [5] **Granti i Disbursimit** (ref nr./emri %)

Zëri i financiar: [6]/...../.....

Numri i zërit	Përshkrimi i zërit	Numri dhe data e kontratës	Emri dhe adresa e Kontraktorit	Përshkrim i shkurtër i kushteve, punimeve ose shërbimeve	Valuta dhe shuma totale e Kontratës	Valuta dhe shuma e shpenzimeve të pranueshme	Shuma e financimit në valutën e shpenzimeve

[7]	[8]	[9]	[10]	[11]	[12]	[13]	[14]
-----	-----	-----	------	------	------	------	------

Nënshkrimi TOTALI (sipas valutës)

[16]..... [15] _____

Shënime për plotësimin e fletës përmbledhëse të kërkesës për disbursim

[1] Emri. Emri i Sovranit. Kjo duhet të jetë e njëjtë si në formularin e kërkesës për disbursim të cilit i përket kjo fletë përmbledhëse.

[2] Data. Data e kërkesës. Kjo duhet të jetë e njëjtë si në formularin e kërkesës për disbursim të cilit i përket kjo fletë përmbledhëse.

[3] Numri i veprimit. Ky numër është i njëjtë si në formularin e kërkesës për disbursim të cilit i përket kjo fletë përmbledhëse.

[4] Numri i kërkesës. Ky është numri i formularit të kërkesës për disbursim të cilit i përket kjo fletë përmbledhëse.

[5] Numri i fletës përmbledhëse. Për çdo kërkesë për disbursim, fletët përmbledhëse duhet të numërohen duke filluar nga 1 dhe numri i tyre total të shënohet në formularin e kërkesës për disbursim të cilit i përket kjo fletë.

[6] Zëri i Financuar nga Granti për disbursim. Ky është zëri i financuar nga granti për projektin që do të financohet nga të ardhurat e disbursimit të kërkuar. Ju lutem, shihni marrëveshjen e grantit për të gjetur emrin dhe numrin e referencës së Zërit të Financuar nga Granti dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen (për shembull, “Zëri i Financuar nga Granti nr. (3b), pajisje, 60%”).

Nëse një kërkesë për disbursim mbulon shpenzimet nga më shumë se një Zëri i Financuar nga Granti, atëherë për çdo Zëri të Financuar nga Granti do të përdoret një fletë përmbledhëse e veçantë.

[7] Numri i zërit. Të gjithë zërat e dokumentit (faturat, kontratat, vërtetimet etj.) duhet të paraqiten në të njëjtin rend siç paraqiten në fletën (t) përmbledhëse. Për të lehtësuar identifikimin, dokumentet duhet të jenë me numër, duke filluar me 1, 2, 3 etj., për çdo kërkesë të re disbursimi dhe ky numër duhet të shënohet qartë në dokument. Numri i përgjithshëm i zërave për totalin e të gjitha fletëve përmbledhëse shënohet në formularin e kërkesës për disbursim.

[8] Përshkrimi i artikullit. Ju lutem, përshkruani çdo artikull, p.sh.: “faturë”, “vërtetim”, “certifikatë inxhinieri”, “përkthim i [...]” etj.

[9] Numri dhe data e porosisë së kontratës. Rekomandohet që kontratës t’i jepet një numër origjinal kur të hartohet ndërmjet Subjektit të Projektit dhe Kontraktorit. BERZH-i do ta miratojë këtë numër për mbajtjen e të dhënave të veta. Nëse kontratës nuk i është dhënë një numër origjinal, BERZH-i do t’i caktojë asaj një numër dhe do të informojë Sovranin në momentin e miratimit. Nëse Sovrani nuk e di numrin në momentin e plotësimit të fletës përmbledhëse, kjo pjesë mund t’i lihet BERZH-it për ta plotësuar.

Në këtë kolonë duhet të jepet edhe data e kontratës/porosisë së blerjes.

Shënim. E njëjta kontratë mund të shfaqet në më shumë se një kërkesë Disbursimi, nëse dorëzimi i mallrave, punëve ose shërbimeve (shihni [11]), dhe rrjedhimisht pagesa për këto mallra etj., bëhet në faza.

[10] Emri dhe adresa e kontraktorit. Emri dhe adresa e palës tjetër (Kontraktori) në kontratën/porosinë e blerjes, siç përshkruhet në [9].

[11] Përshkrimi i shkurtër i mallrave, punëve ose shërbimeve. Këto mallra, punë ose shërbime duhet të korrespondojnë me detajet e parashikuara në kontratë ose dokumente të tjera të paraqitura dhe duhet të përfshihen në Zërin e Financuar nga Granti të specifikuar në [6].

[12] Valuta dhe shuma totale e kontratës. Shuma totale, në valutën origjinale, të kontratës së shënuar në [9].

[13] Valuta dhe shuma e shpenzimeve të pranueshme. Për shpenzim: shuma totale e kërkueshme ose e paguar, në valutën origjinale, siç mbulohet nga faturat ose dokumentet e tjera të renditura në [7] dhe [8]. Kur ka më shumë se një “zë” për çdo shpenzim, (p.sh. një faturë, certifikatë dhe vërtetim, të gjitha për të njëjtin shpenzim), ata zëra duhet të vendosen në kllapa dhe vetëm një shumë duhet të specifikohet në këtë kolonë.

[14] Shuma e financimit. Për çdo shumë të renditur në kolonën [13] duhet të ketë një shumë korresponduese në këtë kolonë [14], të llogaritur në përqindjen e deklaruar në [6] që korrespondon me kategorinë e kësaj flete përmbledhëse. Shuma e financimit duhet të jetë në valutën origjinale të kontratës dhe shpenzimeve (kolonat 12 dhe 13). Kjo mund të jetë ose jo e njëjtë me valutën e huas ose valutën e pagesës.

[15] Totali. Shumat e financimit, siç renditen në [14], duhet të shtohen në një shumë totale për valutë. Për kërkesat e drejtpërdrejta të disbursimit, shuma(at) e dhëna këtu duhet të korrespondojnë me shumën(at) e dhëna në [9] të formularit të kërkesës direkte për disbursim.

[16] Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkesës duhet të nënshkruhet nga ose në emër të Sovranit. Shihni kërkesën për formularin e Disbursimit për kërkesat e nënshkrimit.

SHTOJCA 2
FORMA E LETRËS ME ANË TË SË CILËS CAKTOHEN NËNSHKRUESIT E
AUTORIZUAR

[Të shtypet në letrën me kokë të Subjektit të Projektit]

[Data]

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
5 Bank Street
London E14 4BG
United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Shërbimeve Bankare

Lënda: Veprimi nr. 53468 (Komponenti i Grantit)
Letra me anë të së cilës caktohen Nënshkruesit e Autorizuar

I nderuar zotëri/ zonjë,

Duke iu referuar marrëveshjes së grantit të datës [datë] (“Marrëveshja e Grantit”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Sovrani”), HEKURUDHA SHQIPTARE SHA (“Entiteti i Projektit”)

dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”), ju lutemi, kini parasysh që personat, nënshkrimet model të vërtetuar të të cilëve paraqiten më poshtë, janë të autorizua në emër të Subjektit të Projektit [(i)] si përfaqësues i autorizuar i Sovranit për qëllime të seksionit 2.02 (d) të Marrëveshjes së Grantit që të nënshkruajnë kërkesat e disbursimit dhe çdo dokument dhe dëshmi tjetër shoqëruese [dhe (ii) në lidhje me [ndonjë njoftim ose dokument] që do të nënshkruhen në emër të Subjektit të Projektit] të kërkuar ose të lejuar të ekzekutohet sipas Marrëveshjes së Grantit të lartpërmendur.

EMRI	FUNKSIONI	NËNSHKRIMI MODEL
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Të gjitha njoftimet e mëparshme ku jepen nënshkrime të zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar në emër të Subjektit të Projektit sipas Marrëveshjes së Grantit të mësipërm, revokohen.

Me respekt,

Për dhe në emër të:
HEKURUDHA SHQIPTARE SHA

Nga: _____

Emri:

Funksioni:

SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E LETRËS ME ANË TË SË CILËS CAKTOHEN NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

- Letra e mësipërme e autorizimit duhet të nënshkruhet në emër të Subjektit të Projektit nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Subjektit të Projektit.

- Në rast se ndonjë dokument duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, letra e autorizimit duhet ta deklarojë këtë qartë dhe fjalia e parë duhet të rregullohet sipas rastit.

- Nëse nënshkruesit e autorizuar ndahen në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i një zyrtari nga secili grup, kjo gjithashtu duhet të shprehet qartë.